



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

## Kuvendi i Komunës Klinë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

01Nr 06-42501 /23

Klinë, dt 20/12/2023

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur, më 27.02.2023, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkyrytarja e komunës së Klinës, Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përvendoset që gjithë anëtarët e KKSB-së dëgjoi rendin e ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
2. Prezantimi i planit të punës së KKSB-së për vitin 2023,
3. Siguria në Komunën e Klinës,
4. Të ndryshme.

Pika 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Theksoi që shumica e anëtarëve janë prezent dhe që mund të vazhdojnë me mbajtjen e mbledhjes, dhe shfrytëzoj rastin që t'i përvendoset që gjithë, në vendlindje, Don Jetonin, që është për herë të parë në takim i cilës vendëson paraardhësin e tij, Don Arbenin, përvendoset edhe Togerin Skender Morina i cili e zëvendëson Komandantin e Policisë si dhe pyeti nëse të gjithë ishin dakord me miratimin e rendit të ditës.

Pasi ishin të gjithë dakord, zv. Kryesuesja, Marqe Selmanaj, kaloi në pikën e dytë të rendit të

ditës.

## Pika 2. Prezantimi i planit të punës së KKSBS-së për vitin 2023.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Potencoj se çdo vit e rifreskojmë Planin e Sigurisë në Bashkësi dhe të gjitha ato objektiva që janë të parapara, nuk ka shumë ndonjë ndryshim nga viti i kaluar dhe mbledhjet e parapara në vitin që e lamë pas sepse siguria vazhdon të jetë prioritet për të gjithë.

Do të shkojmë me një prezantim më të detajuar. Plani i punës së KKSBS-së përcakton objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të ushtrohen nga anëtarët e KKSBS-së, në përbushjen dhe funksionimin e këtij mekanizmi ky plan synon që të identifikojë qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet, përkatesisht caktimin e detyrave të përcaktuara me Udhëzim Administrativ të Sigurisë në Bashkësi.

Roli i KKSBS-së në Komunën tonë ka rëndësi të veçantë sepse identifikon dhe i përbledh shqetësimet e qytetarëve nëpërmjet përfaqësuesve të bashkësive etnike, fetare, sociale, profesionale dhe ato shqyrtohen bashkë me përfaqësuesit institucional të Komunës dhe organeve të Sigurisë.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ, KKSBS-ja në përgjithësi ka të obliguara të mbajë gjashtë takime të domosdoshme, mirépo në raste të veçanta, në qoftë se ka kërkesë, këto takime mund edhe të shtohen.

Fokusi kryesor është gjendja e sigurisë, ku edhe e keni parë në mbledhjet e kaluara që gjithmonë për çështjen e sigurisë raporton Komandanti i Policisë ose sikur në rastin sot, që është Togeri i deleguar nga Komandanti, pjesë tjetër të Sigurisë në Bashkësi i kemi të gjitha elementet që i takojnë një sigurie në të gjitha fushat sikur që janë p.sh., arsimi që ka të bëjë me sigurinë në shkolla, zgjerimi i rrjeteve të kamerave që ka filluar dhe është në përfundim e sipër, rregullimi i pjerrinave në shkolla që në disa ka mbetur ende pa përfunduar, vendosja e kamerave te stacioni i Policisë sepse një pjesë e qytetit është e mbuluar por kanë mbetur edhe disa pjesë, mandej e kemi shtuar edhe ndriçimin e rrugëve në afërsi të shkollave, në mënyrë të veçantë e kemi shtuar të shkolla e fshatit Gremnik që ka ardhur si iniciativë e disa nxënësve të asaj shkolle, largimi i deponive të egra, në kuadër të kësaj largimi i deponive ose materialeve të ngurta që e shëmtojnë e dëmtojnë qytetin, këtu hyn edhe mbrojtja e ambientit, pjesë tjetër është vetëdijesimi i të rinjve dhe mbrojtja e tyre nga dukuritë negative që e ndikojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre, rreziku me theks të veçantë në shkollat fillore dhe hapësirat e shkollave të mesme, informimi i nxënësve për dhënen e ndihmës së parë etj. Këto janë disa nga objektivat, mandej aktivitetet zhvillohen përmes planit të KKSBS-së, bartës të këtyre aktivitetave janë së përsht anëtarët e KKSBS-së, rezultet e pritura janë iniciativa të përbashkëta që zgjidhin sëmundjet e lëmet në bashkësi dhe afatet kohore janë nga janari, dmth brenda një viti të caktuar.

E gjithë puna që bëhet në kuadër të KKSBS-së, të gjitha aktivitet janë pa kosto materiale, i vetmi

kosto që është i paraparë është pagesa e anëtarëve të KKSBS-së të cilët i plotësojnë kushtet e parapara që janë të rregulluara me Ligjin për Siguri në Bashkësi dhe që buxheti është i aprovuar në Kuvendin Komunal të Komunës së Klinës. Në pikë të shkurta u mundova ta sqaroj për ata që nuk ishin pjesë e KKSBS-së më herët, dhe shpresoj që ky vit të jetë vit i mbarë dhe këtë planifikim që e kemi paraparë ta realizojmë në mënyrën më të mirë të mundshme sepse kjo shkon në dobi të qytetarëve të Komunës së Klinës. Nëse mendoni se ka mbetur diçka dhe shkon në sigurinë e qytetarit, nuk do të thotë që gjithçka mund të jetë e shkruar, por, mund ta realizojmë në ditët ose takimet tonë në vazhdim. Kaq ishte për sa i përket Planit të Punës së KKSBS-së.

**Z.Jeton Sokoli:** Përrshëndetje për të gjithë, kam një pyetje lidhur me Planin e punës: a ka pasur grup punues për hartimin e këtij plani punues, nëse po, a janë anëtarët e grüpuit të KKSBS-së apo kush ka qenë pjesë e hartimit të këtij plani?

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Pjetje shumë me vend, fillimi shumë kur e kam marrë planin e KKSBS-së ka pasur shumë paqartësi sepse KKSBS-ja gjatë dy viteve të fundit nuk ka funksionuar për shkak të pandemisë ose ku e di unë pjesa tjetër dhe me delegimin e detyrës nga Kryetari. Plani është plan i detajuar, i mëhershëm, i punuar, i analizuar dhe i prezantuar në Kuvendin Komunal, në përpilimin e Planit janë marrë niveli lokal ose komunal, duke i paraparë problemet që shihen, problemet që dihen në shkolla, duke marrë statistika nga Drejtoria e Arsimit, nga Policia, nga organizatat ose organet brenda komunale, dhe për këtë pyetja ime ishte se nëse diçka na ka mbetur pa u përfshirë. Unë gjatë përpilimit të planit jam munduar që me qenë më kreative, por, nuk mund t'i ikësh sigurisë në bashkësi, sigurisë së rrugëve, mandej sigurisë në shkolla, mirëpo nëse ju mendoni që një temë ose diçka që ne nuk e kemi paraparë në planin e punës, lirisht do të jemi bashkëpunues dhe do t'i bënte mirë këtij plani, por, nëse në të ardhmen e shoh që duhet të përpilohet një plan i tillë, që na ka ikë diçka dhe që duhet të jetë një plan punues, atëherë pse jo, do të mblidhem i do të bëjmë punë më të mira.

**Z.Jeton Sokoli:** Po besoj që në të ardhmen do të ishte mirë që të ketë një grup punues, pikërisht për disa tema që i përmende më herët, sidomos për të rinjtë, e di që janë të parapara të gjitha por do të ishte mirë që të ketë edhe hapa konkretë dhe plan konkret se çka mund të bëjmë ne si anëtarë për të rinjtë, për vetëdijesimin e tyre ndaj dukurive negative.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Unë kam bërë disa ndërhyrje dhe përmirësimë, por nuk është që ka ndryshuar diçka nga plani i kaluar, ajo çka ti e the unë i lexova vetëm objektivat sa i përket punës, anëtarët e KKSBS-së janë të lirë të marrin iniciativa, aktivitete përmes Drejtorisë së A... Shëndetësisë apo se cilës Drejtori që ju dëshironi t... qasje, ne e kemi obligim pë... Policisë të organizojmë edhe trajnime të ndryshme p... guri të fëmijëve dhe nxënësve tanë nëpër shkolla.

Për çkado që të jetë, ne jemi këtu, për aq sa kemi mundësi me ju dhanë sqarime.

### **Pika 3. Siguria në Komunën e Klinës.**

**Toger Skender Morina:** Përshëndetje Kryesuese, përshëndetje për të gjithë! Unë jam Toger Skender Morina, ku sot do ta zëvendësoj Komandantin. Në përgjithësi, gjendja e sigurisë është e qetë, nuk kemi ndonjë informacion të theksuar që ta përmendim.

Krahasimi për muajin janar 2022-2023, raste të inicuara në janar 2022 kanë qenë 54 ndërsa në janar 2023 janë 39, kemi rënë 27% të rasteve të inicuara, tek veprat penale kemi pasur 37 vitin e kaluar, këtë vit janë 29, kemi rënë 21%, zbulueshmëria e veprave penale është 82.8%, vitin e kaluar e kemi pasur 75%, aksidente të trafikut me lëndime vitin e kaluar i kemi pasur 3, sivjet i kemi 2, aksidente me dëme 15 kanë qenë në janar 2022, 9 janë këtë vit, persona të lënduar prej këtyre aksidenteve kanë qenë 7, tiketa të shkruara vitin e kaluar kanë qenë 466, sivjet janë 560, 20% më shumë, persona të arrestuar i kemi pasur 38, vitin e kaluar 54, prej të arrestuarve 17 kanë qenë të ndaluar, armë të konfiskuara i kemi 5, 11 copë municion të konfiskuar, asistime kemi pasur vetëm 1, vrasje nuk kemi pasur këtë vit, 1 rast të lëndimit të rëndë trupor, 4 raste i kemi me lëndim të lehtë trupor, për këtë vit vjedhje i kemi 2, vjedhje të lehtë nuk kemi këtë vit, grabitje në tentativë jo, dhuna në familje ka shkuar në rritje, vitin e kaluar i kemi pasur 5 raste të dhunës, kurse këtë vit i kemi 6.

Nuk kemi pasur ndonjë incident madhor, këtë muaj isha ndalur te komuniteti serb që i kemi pasur 3 incidente gjatë janarit.

Ne jemi në bashkëpunim me Drejtoren e Arsimit, ne e kemi në projekt në vazhdimësi ku prej janarit deri në qershor i kemi temat e ndryshme për vetëdijesim të fëmijëve, ku kemi trajtuar temat për bullizmin, ngacmimin seksual, drogat, siguria në trafik, vajtja dhe ardhja e nxënësve dhe mënyra se si të kujdesen për veten e tyre sepse e kemi vërejtur se në disa raste fëmijët nuk kanë qenë të njoftuar ose nuk kanë qenë të udhëzuar prej prindërve që nuk duhet hipur në veturë të dikujt, nuk duhet marrë gjësende nga njerëz të panjohur, duhet me u ndalë në zebra. Besoj që bashkë me Drejtoren e Arsimit do ja dalim, kaq kishte nga raportimi për sot, ju faleminderit që më dëgjuat!

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Faleminderit, Toger! Po, urdhëro, Silvija?

**Znj. Silvija Rashkoviq:** Përshëndetje për Kryesuesen dhe të gjithë të pranishmit në sallë, më vjen keq që Komandanti i Policisë nuk është sot këtu me ne, por, kjo nuk ka rëndësi, zëvendësimi është i mirë. Lidhur me dëmtimin e varrezave, ai që thuhet se e ka lajmëruar rastin, unë kam mësuar se ai nuk jeton këtu, dmth për rastin e dëmtimit të varrezave në shkurt, unë kam q... terren dhe është i njëjti rast që ka ndodhur edhe n... dmth është rast që po përsëritet dh... isha lutur organet e sigurisë që të na ndihmojnë lidh... këto raste, faleminderit!

**Toger Skender Morina:** Ne jemi munduar që në mundësitet tona të gjejmë shkaktarin e këtyre

veprave, hetimet janë duke vazhduar. Ne mund të gjemë dëshmi ose rrethana tjera për të zbuluar, ajo kishte me qenë e mirëseardhur ose për njerëzit që kanë njohuri ose dinë diçka të na jepin informacione. Tash mbetet me prokurorin të shikojmë dhe ta zbulojmë se kush është fajtori.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Josip urdhëro

**Z. Josip Dedaj:** Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë! Sa i përket sigurisë në fshatin Dresnik, gjendja është e qetë këtë vit, me këtë përjashtimin që ne kemi raportuar në takim me Policinë dhe në Këshill të Sigurisë Lokale në lidhje me dëmtimin e disa varrezave në fshatin Dresnik, dmth këto raste nuk janë vetëm në fshatin Dresnik, por, Policia po bën punën e vet. Dhe znj. Kryesuese, për z.Ragip Kryeziun që nuk mund të jetë pjesë e KKSB-së, kisha propozuar që të paktën një mirënjoyje t'i ndahet për punën dhe angazhimin që e bën.

Një problem goxha i madh që nuk u cek nga ju e me siguri ky rast ka qenë edhe në Polici i lajmëruar, është rasti i mësueses Vera Dedaj, në shkollen fillore në fillim të muajit. Rasti është i lajmëruar edhe te Këshilli i Prindërve, edhe te Drejtoria e Arsimit, edhe në Stacionin e Policisë, unë e di që ka qenë bash kërcënim, unë kam folur edhe me familjarët e atij personi, jo njëherë, por disa herë, ju nuk mund as ta paramandoni se në çfarë gjendje ka qenë mësuesja disa ditë. Duhet cekur gjithsesi që është një ndër mësueset që e ka notën mesatare më të lartë 4.7 dhe është një ndër mësueset më të suksesshme në shkollën " Ismet Raci " dhe nuk e di sa ka shkuar hetimi ndaj kësaj pune, drejtori nuk është këtu për ta ditur se çka duan të bëjnë me atë nxënëse; a duan ta lënë në po të njëjtën klasë, prindi nuk ka dëshirë me lënë në të njëjtën klasë dhe unë si kryefamiljar kisha propozuar me bërë një zgjidhje. Është edhe z. Skender këtu, edhe ju Kryesuese, por drejtori nuk qenka, duhet me bërë një zgjidhje në lidhje me këtë mësuese dhe atë nxënëse. Unë e kam edhe zyrën aty te shkolla dhe të them të drejtën më shumë shoh prindër në shkollë sesa nxënës, nuk po e di a është shkollë e prindërve apo shkollë e nxënësve. E respektoj shumë punën që bëjnë Policët por nuk po e shoh të arsyeshme që të shkojë një prind dhe t'i kërcënohet një mësueses pa asnje arsy. Faleminderit!

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Faleminderit, Josip! Për z.Ragip nuk është mjaftueshëm një mirënjoyje por nuk do të mungojë, mirënjoyja më e madhe për të është kur të gjithë qytetarët e Klinës e dinë dhe e vlerësojnë punën e tij, nëse duhet t'i jemi mirënjoyës duhet t'i bashkëngjitemi të gjithë kurdo që z.Ragip merr iniciativë. Bashkëpunimi ynë institucional dhe lokal nuk do t'i mungojë asnjeherë, këtë e them me përgjegjësi të plotë.

Rasti që na ka shqetësuar të gjithëve ka qenë rasti i mësueses, Vera Dedaj. Duke qenë pjesë e arsimit, më ka bërë të ndjehem shumë keq, dhe të gjitha këto i kemi lënë në dorë të drejtësisë dhe jo të individëve për ta ngritur zërin sepse situata ka shkuar direkt aty ku duhet. Shkolla është e prindërtare, është e nxënësve dhe e mësimdhënësve, është trel sh pedagogjik që asnjeherë nuk mund të jepet me i ikë. Rasti që ka ndodhur është rast i shëmtuar dënueshëm, dhuna nuk është e lejueshme në shkolla dhe nuk më shkon në mendje se mësuesja e ka bërë një akt të tillë, por që çdo gjë ka mbetur në dorë të Policisë dhe Drejtorisë së Arsimit. Drejtori ka dalë me një

prononcim ku ka theksuar se do të vijmë në një përfundim duke i dëgjuar të dyja palët, pasi të dëgjohen dy palët ku prindi i jep arsyetimet për rastin dhe mësuesja arsyet e veta dhe do të vijmë në një përfundim.

Uroj shumë që ta ketë kaluar lehtë, por, KKSBB-ja nuk jemi Këshill që marrim masa, ne jemi Këshill që ngremë çështje që i delegojmë diku që të zgjidhen.

**Toger z. Skender Morina:** Rasti është në procedurë dhe varet nga Gjyqtari dhe Prokurori sepse ata i kanë detyrat e shpërndara, por, rasti është trajtuar dhe besoj që edhe rastet tjera kanë për t'u trajtuar siç janë trajtuar të gjitha. Nuk e besoj që ka ndonjë problematikë por këto lloj problemesh nuk e kemi parë vetëm rastin e mësueses, e kemi pasur edhe rastin e fëmijëve tash 12-13 vjeç edhe është pak problem me u marrë policia sepse tash kur e pyet Prokurorin ai thotë lejoj të shkojnë në shtëpi sepse janë të mitur. Janë disa gjëra që duhen kuptuar, që nuk mund t'i trajtojmë menjëherë, por, që me i marrë me korrektësi nuk ka ndonjë problem, rasti i mësueses është në procedurë të hetuesve dhe besoj që ka për të shkuar në vend. Faleminderit!

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Faleminderit, Toger! Po, urdhëroni, hoxhë?

**Hoxhë, z. Fitim Bojaj:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Don Jetonit i urojmë mirëseardhje dhe bashkëpunim, e thatë edhe ju që gjendja e sigurisë është e qetë, e mirë dhe shpresojmë të vazhdojë kështu, unë kisha pasur një propozim te çështja e një barnatore kujdestare që me jua mundësuar qytetarëve që ta kenë një barnatore 24h hapur për çdo nevojë të tyre që e kanë.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Faleminderit shumë, sa kam informacion deri në cilën kohë ka funksionuar nuk e di, por, që të jetë një barnatore hapur e kanë pasur me orar gjatë natës, tash për momentin nuk mundem me ju dhanë përgjigje, por, në seancën e ardhshme besoj shumë që do ta merrni përgjigjen. Po, Josip?

**Z. Josip Dedaj:** Znj Nënkyetare, mund ta them në emër të gjithë qytetarëve të Klinës me shqetësimin më të madh që e kemi ne nëpër fshatra, nëpër lagje sidomos, kur kanë qenë vërvshimet dhe mbrëmë e parmbërëmë që kanë qenë erërat e mëdha, unë mbi 30 herë e kam lajmëruar KEDS-in. Meqenëse është e pamundur që të vijnë në Dresnik për një defekt të vogël ku ka pasur defekte më të mëdha në vende tjera. A do të kishte mundësi që qytetarët me u lidhë direkt me KEK-un në Klinë? Njëra fazë në fshatin Dresnik nuk ka që tri ditë, dhe ne duhet vetëm direkt që ta lajmërojmë Prishtinën, e Prishtinën është shumë problem me marrë në telefon, faleminderit.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Faleminderit, Josip! Një bëra me dorë desha të njoftojë që tash më erdh informacioni për të njëjtën kërkësë që e kam oërrë, është një fshat Radulloc që ka tri ditë që nuk kanë rrymë fare, asnjë fazë, dhe nuk është problemi që nuk ka rrymë, por, krejt

shtyllat janë të rrëzuara dhe paraqet problem për banorët. Sot, në mbledhjen e bordit e kemi ngrësi çështje, jo vetëm për fshatin ku jetoj, por për të gjithë.

Tash, drejtori i Shërbimeve Publike ma dha informatën se ekipet janë duke punuar për rregullimin e shtyllave që janë të dëmtuara dhe besoj që për 2-3 orë do të rregullohet. Nëse ka dikush diçka tjetër, tek pika e fundit e ndryshme?

#### **Pika 4. Të ndryshme.**

**Z. Dalibor Kojic:** Përshëndetje për ju të gjithë! Unë jam prift Dalibor Kojic, duke qenë që është hera e parë që marrë pjesë në këtë takim kam nderë dhe kënaqësi të madhe, dëshiroj që të kemi bashkëpunim të mirë, që të kemi sa më pak probleme dhe mirëkuptim dhe t'i zgjidhim të gjitha problemet e mundshme që mund të na dalin dhe problemet që u cekën në lidhje me varrezat. Shpresojmë ta gjejmë një zgjidhje të përbashkët që gjëra të tillë të mos përsëriten më, një zgjidhje mund të ishte vendosja e kamerave që të mund të shihnim që a ka ndodhur apo jo, faleminderit!

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Faleminderit Dalibor, të përshëndes dhe po besoj që do të bashkëpunojmë si me të gjithë të tjerët, në mënyrën më të mirë të mundshme. Po, urdhëro Don Jeton

**Z. Don Jeton Thaci:** Përshëndetje, jam Don Jeton Thaqi dhe për mua është hera e parë që marr pjesë në këtë Këshill dhe dëshiroj vetëm dy çështje; meqenëse unë jam edhe Kancelar i Ipeshkvisë për gjyqin e Kishës në Kosovë, atëherë unë punoj ditëve të hënë në Prishtinë dhe e kam të pamundur pjesëmarrjen në takim, ndërsa për ditët tjera nuk do të ishte problem. Është kënaqësi të bashkëpunojmë me juve, do të jemi të gatshëm të japim kontributin e Kishës Katolike dhe gjithë besimtarëve për sigurinë e vendit.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Faleminderit, Don Jeton, nuk besoj që është problem që mos me e caktuar ditën e hënë si ditë ku takohemi dhe mundemi me gjetë një ditë të përshtatshme për të gjithë. Po, Josip?

**Z. Josip Dedaj:** Për herë të parë Don Jetoni e bëri një kërkesë e ju aprovua menjëherë, e unë që 12 vite, badihava!

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Josip, mirë që je këtu. SB-së i duhet një zë i fuqishëm, pavarësisht ne në pushtetin lokal a na konvenon ose neshtu që, Josip, mos mungo në mbledhje se përndryshe mbledhja do të zgjaste shumë pak, faleminderit që jep ide të reja. Me kaq po e përmbyll këtë takim, deri në të radhës, gjithë të mirat për të gjithë ju!

Procesmbajtësja,  
Orgeta Sylaj

